



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
MINISTRI

Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë

Tel/fax 04 225678

Nr. 8336 Prot.

URDHËR

Nr. 490, datë 27.12.2005

PËR DHËNIEN Ë STATUSIT  
“SHKOLLA TË NIVELIT KOMBËTAR” DISA SHKOLLAVE TË MESME  
TEKNIKE, PROFESIONALE DHE SOCIAL-KULTURORE

Mbështetur në Nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar”, ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.07.1998 dhe me propozim të Drejtorisë së Zhvillimit të Kurrikulës,

URDHËROJ:

A. Shkollat e mëposhtëme të kenë statusin “Shkolla të mesme të nivelit kombëtar” :

- |  |         |
|--|---------|
| 1. Shkolla e mesme Bujqësore “Kristo Isak”                   | Berat   |
| 2. Shkolla e mesme Profesionale “Beqir Çela”                 | Durrës  |
| 3. Shkolla e mesme Profesionale “Ali Myftiu”                 | Elbasan |
| 4. Shkolla e mesme Pedagogjike “Luigj Gurakuqi”              | Elbasan |
| 5. Shkolla e mesme Profesionale “Demir Progni”               | Korçë   |
| 6. Shkolla e e mesme Agro-biznesit “Irakli Tërova”           | Korçë   |
| 7. Shkolla e mesme Profesionale “Arben Broci”                | Shkodër |
| 8. Shkolla e mesme Pyjore                                    | Shkodër |
| 9. Shkolla e mesme Teknike Ekonomike                         | Tiranë  |
| 10. Shkolla e mesme Hoteleri-Turizëm                         | Tiranë  |
| 11. Shkolla e mesme e Ndërtimit “Karl Gega”                  | Tiranë  |
| 12. Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja “Asim Vokshi”         | Tiranë  |
| 13. Shkolla e mesme Artistik “Jordan Misja”                  | Tiranë  |
| 14. Shkolla 9 vjeçare dhe e mesme Koreografike               | Tiranë  |
| 15. Shkolla e mesme e mjeshtërisë së futbollit “Loro Boriçi” | Tiranë  |
| 16. Shkolla e mesme Industriale “Pavarësia”                  | Vlorë   |
| 17. Shkolla e mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”                | Fier    |

18. Shkolla e mesme Sportive "Bernardina Qeraxhia"  
19. Shkolla e mesme Teknike Elektrike  
20. Shkolla e mesme e agrobiznesit Golem

Durrës  
Tiranë  
Kavajë

- B. Shkollat e mësipërme të funksionojnë mbi bazën e Rregullores së shkollave të mesme teknike, profesionale dhe social-kulturore me statusin "Shkolla të nivelit kombëtar", që i bashkëlidhet këtij Urdhri.
- C. Drejtori dhe nëndrejtori i shkollave kombëtare emërohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nëpërmjet zhvillimit të konkursit. Konkursi organizohet nga DAR ose ZA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Drejtorinë e Zhvillimit të Kurrikulës në MASH. Pas zhvillimit të konkursit, DAR ose ZA i paraqesin Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës tre kandidaturat më të mira për të emëruar një prej tyre. Edhe shkarkimi ose transferimi i Drejtorit apo Nëndrejtorit të Shkollave Kombëtare bëhet me propozim të DAR ose ZA dhe miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- D. Mësuesit e këtyre shkollave do të emërohen me konkurs, i cili do të organizohet nga një juri e përbërë prej pesë anëtarë, një nga MASH, një nga DAR ose ZA, dhe tre nga shkolla përkatëse (një nga këta të tre është drejtori i shkollës). Emërimin e tyre e bën Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve në MASH.
- E. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve, Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe DAR dhe ZA .
- F. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë. Urdhëri i mëparshëm Nr.350, date 03.12.2001 çfuqizohet.



**MINISTRI**

**Genc POLLO**